



REPUBLIKA E KOSOVËS--REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA: HANI I ELEZIT



02/Nr. 312/2011  
Data: 05.07/2011

DATA:	05.07.2011
PËR:	Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin e Komunës
NGA:	për Kryetrari i Komunës Rufki Suma <i>Rufki Suma</i>
LËNDA:	Raporti gjashtëmuorë i Kryetarit të Komunës për vitin 2011

Të nderuar ;

Të bashkangjitur me këtë shkresë ju paraqesim raportin e punës së Kryetarit të Komunës për gjashtëmuorin e vitit 2011 dhe drejtorive Komunale.

Me respekt



REPUBLIKA E KOSOVËS--REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA: HANI I ELEZIT



## RAPORTI GJASHTËMUJOR I KRYETARIT TË KOMUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2011

Hartoi dhe përpunoi: **Grupi i punës**

1. Rufki Suma, kryetari i komunës,
2. Muzafër Dernjani, nënkryetar i Komunës,
3. Fari Kalisi, Drejtor i Administratës,
4. Shabi Rexhallari, drejtor për Buxhet dhe Financa,
5. Nazim Laçi, drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport,
6. Safet Bushi, drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,
7. Meqail Vila, drejtor për Urbanizëm, Kadastër Mbrojtje të Ambientit,
8. Rufat Shkreta, drejtor i Shërbimeve publike,
9. Xhevdet Shkreta, drejtor i zhvillimit Ekonomik,
10. Besnik Reçi, drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe zhvillim Rural

Hani i Elezit, Korrik 2011

7. Marrëveshje mirëkuptimi me Agjensionin për zhvillim Rajon(AZHR) në përkrahje të zhvillimit të turizmit rural
8. Marrëveshje mirëkuptimi për përkrahje të zyrës Kadastrale me GIZ-in
9. Marrëveshja me UN-HABITAT-in për hartimin e dokumenteve Strategjike të komunës sonë si;
  - Plani Zhvillimorë Strategjik
  - Plani zhvillimorë Urban
  - Vlerësimi strategjik mjedisorë

Duhet të theksohet se gjatë kësaj periudhe kohore kemi pasur edhe iniciativa të suksesshme të institucioneve shkollore si ;

-Donacioni për shkollën e Mesme „Dardania” në kuadër të KEC-it në vlerë prej afro 9.000 euro

-Donacioni për Shkollën Fillore „Ilaz Thaçi “ në kuadër të projektit SOS –Fshati në vlerë prej 10.000 euro që gjithsesi vlej në të urohen,por edhe të shoqatave të ndryshme bëmirese si „Human Appel International” në ndihme fëmijëve bonjak të komunës sonë „Shoqata Humanitare „Ti ndihmojmë Drenicës” me donacion për QKMF-në,

Por gjithsesi edhe komuna si institucion ka bërë përpjekje që brenda mundësive të ju ndihmoj atyre që kanë nevojë ,duke përkrahur iniciativën e Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së për të ndërtuar shtëpinë e Familjes së Dëshmorit Imri Curri.

Në kuadër të bashkëpunimit me organizata të ndryshme janë zhvilluar edhe vizita studimore jashtë vendit si në Maqedoni, Shqipëri, Slloveni, Irlandë të Veriut...

Vlen të theksohet se jemi në bisedime edhe me donatore të tjerë që kanë treguar gatishmëri që të përkrahin komunën tonë në projekte të ndryshme dhe të cilat shpresojmë të konkretizojmë.

Të nderuar këshilltar

Fillimi i vitit i solli komunës sonë edhe një sfidë ,epilogu i së cilës është ende i paparashikueshëm-Privatizimi i „Sharrcemit”

Unë si kryetarë i komunës i kam marrë të gjitha hapat e mundshme ligjore për ta kontestuar këtë „shitblerje Jolegjitime” duke iniciuar procedura ligjore në të gjitha instancat relevante dhe do të mbes konsekuent në përpjekjet e mia legjitime dhe me mandatin e dhënë nga ju për të mbrojtur pronën dhe të drejtat e punëtorëve të këtij kombinati.

Gjithashtu kemi percjellur deri në gjykatën kushtetuese tërë materialin e nevojshëm për ta hequr nga përdorimi emertimin gjeneral Jankoviq

Sigurisht se Procesi i Regjistrimit të popullatës ishte një projekt shumë i rëndësishëm si për Republikën e Kosovës por edhe për Komunën tone.

Mund të deklaroj këtu para jush se me shumë sukses e kemi menaxhuar këtë sfidë falë angazhimit dhe seriozitetit të zyrtarëve tanë ,por edhe të një vetëdijesimi shumë të mirë të qytetarëve që ti përgjigjen këtij projekti.

4	<i>Furnizime pastrimi nga janari deri ne maj per departamentet e komunes</i>	ATLLAS	2,775.88	po
5	<i>Furnizim me medikamente per nevoja te QKMF-se</i>	ATOM MED	5,297.50	po
6	<i>Furnizim me gypa per nevoja te ujesjellsit te qytetit</i>	BERISHA COMPANY	2244.00	po
7	<i>Furnizim me kose bari dhe kose te murit te gjalle</i>	BERTI IMPEX	715.00	po
8	<i>Mirembajtja e aparateve (te stomatologjise, labororit dhe emergjences) te QKMF-se</i>	ELEKTRO ARDI	617.00	po
9	<i>Shpallje dhe publikime per nevoja te komunes (ketu perfshihen edhe borxhet)</i>	INFOPRESS	1,001.23	po
10	<i>Shpallje dhe publikime per nevoja te komunes (ketu perfshihen edhe borxhet)</i>	KOSOVA SOT	580.00	po
11	<i>Furnizim me tabele per komune dhe emertimin e rrugeve</i>	KROSA	980.00	po
12	<i>Sigurimi i toyota runnerit (borxh 2010)</i>	DARDANIA	243.60	po
13	<i>Furnizim me unireffa per departamentet e komunes</i>	LITOGRAFIA	233.40	po
14	<i>Furnizim me mobilje per dy drejtorite e reja</i>	NTP. "MOBEST"	998.00	po
15	<i>Mirembajtja e veturave te komunes</i>	NTSH. "BESA"	6,675.00	po
16	<i>Transporti i personave me hemodialize (ketu hyjne edhe borxhi i mbetur nga 2010)</i>	AUTO TAXI S.AXHAMI	3,715.62	po
17	<i>Material per mirembajtje per nevoja te komunes</i>	SFERA	1,340.00	po
18	<i>Furnizim me kalendare per komunen e Hanit te Elezit</i>	STAR-GRAF	996.00	po
19	<i>Sherbime te publikimeve</i>	ZERI	104.40	po
20	<i>Meremetimi i zyreve te gjendjes civile</i>	KRAS	9,814.33	Jo (eshte ne ekzekutim)
21	<i>Kanalizimi i nje pjese te lagjes</i>	3 D PROJECT	9,863.40	Jo

Përfundimi i librave të protokollit 2010 dhe hapja e librave për vitin 2011  
Bashkpunimi me komunat e Kosovës e sidomos me komunën e Kaçanikut  
Gjatë këtij gjashtëmujori kemi pasur takime të rregullta me zyrtar të avokatit të popullit ku kemi siguruar një zyre për takim me qytetar ( një herë në muaj).

Takime me oraganizata të ndryshme USAID, LOGOS si dhe me KFOR-in

Takime te rregullta me asosacionin e kolegjiutit të Drejtorve të Administratës

Gjatë këtij gjashtëmujori kemi bashkpunuar me Ministrin e Punëve të Brendshme -Departamenti i Gjendjes Civile- për hapjen e zyrës për dhënien e dokumenteve personale si dhe hapjen e zyrës për regjistrimin e automjeteve për qytetaret e Hanit të Elezit ,ku Komuna ka bërë përgatitjen e zyreve të këtyre shërbimeve vetem pritet hapja nga MPB.

Drejtori i Administratës ka pasur takime me punëtorët e sektorit rreth punëve dhe probleme të këtij sektori, kurse rregullisht gjatë orarit të punës janë vizituar punëtorët nëpër zyre .

Drejtorja e Administratës nga muaji shkurt deri ne muajin prill ka pasur nje angazhim ne procesin e regjistrimit të popullsisë .

Gjatë këtij gjashtëmujori kamë qenë i angazhuar në zgjedhjen e kryesive të fshatrave dhe lagjeve të Komunës së Hanit të Elezit, ku deri me tani shumica e fshatrave kanë zgjedhur kryetarët dhe Këshillin e fshatit sipas rregullores së miratuar ne kuvendin e komunës ( nuk janë mbajtur zgjedhjet në Pustenic, Lagje e re, Dimçë.)

Funksionalizimi i rrjetit të E-qeverisjes për forcimin e standardizimit të faqeve të internetit, si dhe trajnimi i zyrtave.

Është bërë paisja e disa zyreve me inventar si dhe barkodimi i inventarit të Administratës së Komunës .

Furnizimi me pajisje të teknologjisë informative si dhe furnizim me tonera për nevoja të administratës komunale .

Jam angazhuar në përgatitjen e manifestimeve të 17 shkurtit dhe 11 qershorit .

Dorzimi i raporteve çdo muaj në Entin e Statistikës së Kosovës dhe në departamentin e regjistrimit civil në Prishtinë.

Trajnimi i zyrtarve për të drejtat e njeriut nga MAPL

Në kuadër të drejtorisë së administratës veprojnë këto zyre;

**ZYRA E PRITJES**-Shërbimi i Shkrimores ka bërë regjistrimin ,evidentimin përcjelljen dhe shpërndarjen e **1.920**. lëndëve duke përfshirë të gjitha sektorët dhe shërbimet e Kuvendit të Komunës, **2960** lëndë për zyrën e ofiqarisë .  
Është bërë verifikimi (nostrifikimi) i 103 kopjeve te dokumenteve

**ZYRA E OFIQARISË**; Sektori i ofiqarisë i cili vepron në kuadër të sektorit të administratës është një zyre e cila është e angazhuar,funksionon shumë e organizuar .

Shprehur në shifra ky shërbim ka kryer këto shërbime për palë;

Gjatë kësaj periudhe janë inkasuar 6.434.50€, duke mos llogaritur ato kategori të cilat sipas vendimit komunal janë të liruar nga taksa.

## ZYRA E ARKIVIT

Fillimisht detyrë e kësaj zyre ka qene grumbullimi i materialit qe sipas rregullës duhet te procedohet si material arkivor. Kjo zyre është duke vazhduar me arkivimin e lëndëve në zyrën e arkivit sipas planit 2010, vazhdon edhe digjitalizimin elektronik të të dhënave ,me një përshkrim te shkurt te përmbajtjes se dokumentit,dhe burimit te dokumentit.

Gjatë vitit 2010 është bërë instalimi i sistemit me serverin e zyrës së pritjes për ruajtjen e të dhënave në mënyrë elektronike.

**Zyra e transparencës** me qëllim të një informimi sa më të mirë të opinionit mbi të gjitha zhvillimet në komunën tonë.Kjo zyre ka shfrytëzuar të gjitha mjetet e informimit duke filluar me të gjitha publikimet në web faqen zyrtare të komunës si dhe ka pasur një bashkëpunim të mirë me mediat si shtypin ditorë ashtue edhe elektronikë.Gjatë këti gjashtëmujori janë publikuar shumë infomata kryesisht afirmative për zhvillimet në komunën tonë.

Zyra e transparencës ka qenë bartëse e aktiviteteve në infomimin e qytetareve për debatet publike, diskutimet publike, dëgjimet publike për dokumentet strategjike si planin zhvillimor strategjik,urban dhe vlerësimin mjedisorë.

## DEPOJA

Depoja ka vazhduar me furnizimin me material për Administratën Komunale sipas planit dhe nevojave si dhe shpërndarjen e materialit në bazë të kërkesave të zyrtarëve të miratuara nga Kryetari si dhe ka bere regjistrimin e materialit .

Në depo është bere instalimi i aparatit të barkodimit si dhe është bërë barkodimi i inventarit në Administratën Komunale.

## DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Drejtoria për buxhet dhe financa prej periudhës janar – qershor 2011 aktivitetin e vet e ka orientuar kryesisht në përmbushjen e aktiviteteve dhe objektivave të cilat i ka parashtruar vetes dhe kompetencave që i ka.

Aktiviteti i drejtorisë ka qene i përqendruar në realizimin e buxhetit sipas dinamikës se planifikuar dhe menaxhimin sa me efikas te buxhetit.

**Sektori i thesarit – pagesave** - ky sektor sistemin e pagesave, të hyrave dhe dalurave e ka të instaluar me një program të nivelit qendror të Ministrisë së Financave i ashtuquajturit Sistem i Informatave mbi Menaxhimin Financiar të Kosovës (SIMFK).

Gjate kësaj periudhe gjashtëmujore ka pasur këto aktivitete :

- Përpunimi , harmonizimi dhe barazimi i evidencave të detajizuara të të gjitha llojet e të hyrave dhe të dalurave buxhetore sipas programeve buxhetore , fondeve dhe kodeve ekonomike .

- Mbajtja e evidencave të sakta dhe shtimi i efikasitetit në arkëtimin dhe bankimin e pagesave – inkasimet në arkë , depozitimet bankare , transferi i të hyrave komunale dhe alokimin e këtyre mjeteve nga fondi i BQK-së.

- Llogaritja dhe realizimi i të gjitha pagesave nga granti qeveritar të destinuar për pagesën e pagave dhe mëditjeve, të këshilltarëve komunal dhe komiteteve të ndryshme.

- Tërheqja e avanseve të parave të gatshme të “pety cashit” për programet buxhetore dhe rimbushjet e tyre sipas kërkesave dhe vendimeve të miratuara në shumën e limituar të pagesave të faturave deri nën 100€.

**Sektori i tatimit në pronë** – gjatë kësaj periudhe kjo zyre ka pasur këto aktivitete:

- Kryerja e të gjitha punëve organizative , informative dhe zbatimi i formave me efikase për përfshirjen sa më të mirë të zonave tatimore dhe për fillimin e punës për vitin 2011, me programin e propozuar dhe të furnizuar nga Ministria e Financave.

- Regjistrimi dhe mbajtja e saktë e pagesave të realizuara dhe evidentimi i borxheve nga tatimobliguesit për periudhën e deritanishme 2012-2011( kalkulimi i kamatave dhe ndëshkimeve) krahas operimit me të dhënat me softuer , mbajtja e të dhënave të posaçme në Excel.

- Gjatë kësaj periudhe kemi pasur 24 ankesa prej qytetarëve prej tyre 21 janë shqyrtuar dhe miratuar, kurse 3 janë refuzuar.

- Është miratuar rregullorja e tatimit në pronë.

- Të hyrat nga tatimi në pronë për periudhën janar – qershor janë arkëtuar 33,145.93€ që do të thotë se janë realizuar 56.25% nga faturimi dhe borxhet.

- Vlen të theksohet se shpërndarja e faturave të tatimit në pronë për vitin 2011 nuk është bërë me urdhër të kryetarit, sepse kemi kërkuar nga Ministria e Financave që ti hiqet emri Gjeneral Jankoviq.

**TË HYRAT E DREJTORISË PËR BUXHET DHE FINANCA PËR PERIUDHËN  
JANAR – QERSHOR 2010/11 - krahasimi**

Nr	Përshkrimi	2010	2011	krahasimi
1	Të hyrat nga tatimi në pronë	17,280.20	33,145.93	15,865.73
2	Të hyrat nga regjistrimi i veturave	7,910.00	8,250.00	340.00
3	Të hyrat nga aktvendimet	3,680.00	59,405.00	55,725.00
4	Të hyrat nga lejet e punës	490.00	1,550.00	1,060.00
	<b>Totali</b>	<b>29,360.20</b>	<b>102,350.93</b>	<b>72,990.73</b>

Në raport me vitin 2010, të hyrat e Drejtorisë për buxhet dhe financa për vitin 2011 kanë shënuar një rritje prej **348.60%**.

**DREJTORIA PËR ARSIM, KULTURË, RINI DHE SPORT**

DKA-ja gjatë kësaj periudhe kohore ka kryer punët dhe detyrat të cilat kanë ndihmuar në përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe ngritjen e cilësisë në mësim përmes pajisjes së shkollave me material të nevojshëm si dhe organizimin e trajnimeve për mësimdhënës.

Janë mbajtur takimet e rregullta në MASHT , te kryetari dhe me drejtorët e shkollave.

Për të përcjellë punën dhe për të parë për së afërmi si po zhvillohet procesi edukativo-arsimor dhe problemet që kanë , bashkë me shefin e arsimit dhe pedagogun gjatë kësaj periudhe janë vizituar shkollat tona: 05.01.2011 -“Ilaz Thaçi”,“V.Ballazhi” , “K. E Diturisë”( përgatitjet për gjysmë vj. e dytë).

12.01.2011 - “Ilaz Thaçi”(punët që duhet kryer në shkollën e Laçit).

18.01.2011 - “Ilaz Thaçi” dhe “Dardania” (si është gjendja me lëndë djegëse).

31.03.2011 - “Dardania” (me pa ekspozitën e nxënësve) .

14.04.2011 - Seqishtë , Krivenik , Gorancë (kontrollimi i përgjithshëm).

15.04.2011 - “Dardania” , “I.Thaçi” (me përfaqësuesit e MAPL rreth projekteve).

18.04.2011 - “I.Thaçi” , “Dardania” (kontrollim i përgjithshëm) .

25.05.2011 - Pustenik , Laç , Seqishtë (kontrollim i përgjithshëm).

15.06.2011 - Seqishtë ( test me kl.e V-të).

21.06.2011 - Rezhancë (bisedë me prindërit rreth mundësisë së transferimit të nxënësve në Gorancë.



## DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Drejtorja e DSHMS-së ne bazë të planifikimit të punës gjatë këtij gjashtëmujori ka kryer punët e planifikuara sipas planit të punës për vitin 2011 . Drejtorja e DSHMS-së përveç **shëndetësisë primare** të QKMF-së, në vete përfshin edhe punët e **shërbimit social** si dhe **inspektores sanitare**.

Vlenë të theksohet se nga janari i këtij viti QKMF-në e udhëheqë Drejtori i QKMF-së.Gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore kemi patur edhe zëvendësime të punëtorëve me mardhenie të përhershme të punës me punëtor të rinjë e sidomos për periudhën e lehonisë. Në muajin Maj është pensionuar një punëtor. DSHMS-ja ka realizuar objektivat e saj sipas planifikimit për periudhën janar –qershor dhe atë:

- Sigurimin me kohe te medikamenteve nga lista e barnave esenciale nga MSH.
- Ofrimin e shërbimit shëndetësor njëzet e katërorësh për qytetarët .
- Ofrimin e analizave laboratorike dhe shërbimit stomatologjik ,ku për këto shërbime DSHMS-ja ka investuar mjete për medikamente dhe reagensa ne vlerë prej 5297.50 euro.
- Shërbimi i vaksinimit me kohe ka kryer vaksinimin e paraparë sipas moshës dhe llojit të vaksinimit,
- Hartimi i rregullores për mbrotjen e shendetit per të miturit,
- Sigurimi i transportit për pacientët për qendrat spitalore ne ate regjionale-Ferizaj dhe QKUK, Prishtinë,
- Sigurimi i transportit për pacientët të cilet janë në hemodializë, Hani i Elezit – Gjilan,
- Kujdesi i veprimtarisë private shëndetësore (barnatore,stomatologji ),
- Kontrollimi i vazhdueshem i inspektores sanitare ne lokalet afariste dhe te tjera ne mbrotje te shendetit te qytetarëve,
- Raportimi i rregullt i të dhënave të SNS në DMS Prishtinë,
- Aktivizimi për javën kulturore i Drejtorisë në nivel Komunal,
- Angazhimi ne regjistrimin e popullatës si anëtarëi i KKR,
- Menagjimi i i mirë i mjeteve financiare paga dhe mëditje,sherbimeve e mallrave, si dhe shpenzimet komunale.

Drejtorja e DSHMS-së gjatë këtij gjashtëmujori ka prezantuar në takime të rregullta ne bordin e drejtorëve me kryetarin. Çdo javë aktivitete dhe problemet janë paraqitur ne këto takime. Ka patur edhe një bashkëpunim me MSH, MPMS, PK, DKSHMS te Kaqanikut dhe Ferizajit, Spitalin regjional, Zyren Japoneze, „Caritasin”,INOP”, „Logos” dhe organe tjera të cilat kane shprehë bashkëpunim me DSHMS-në ka bërë vizita permanente QKMF-së dhe AF-Gorancë,DSSHMS-ja ka përcjell punën e punëtorëve të QKMF-së dhe shërbimit social, dhe atij sanitar.

1. **Hartimi i planit zhvillimor Urban:** -Në fillim të muajit Gusht 2010, me vendim të Kuvendit Komunal dhe në bazë të Ligjit mbi Planifikimin Hapësinor 2003/14, ka filluar hartimi i Planit Zhvillimor Urban.

Edhe ky plan ka përfunduar së hartuari me mbështetje teknike të UN-HABITAT-it, financuar nga SIDA. Pas përfundimit të gjithë kapitujve të PZHU-së, përveç organizimit të diskutimeve publike për disa fusha tematike të PZHU-së, është mbajtur edhe diskutimi final i draft PZHU-së i cili ka qenë i hapur në shqyrtim publik që nga 29 Prill 2011 deri me 29 Maj 2011.

Parashikimet janë se ky plan do të përfundon nga fillimi i gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2011 kur dhe pritet miratimi i PZHU-së nga Kuvendi Komunal pas marrjes së Pëlqimit nga MMPH për PZHK.

## II Projektet Kapitale Investive

Në vazhdimi kemi qenë të angazhuar në të gjitha projektet investive kapitale përmes:

- Përgatitjes së Aplikacion projekteve dhe paramasave dhe parallogarive për projektet të ndryshme në këtë periudhë siç janë:
  - Sistemi i kanalizimit Dheu i Bardhë-Uji i Thartë,
  - Sistemi i kanalizimit atmosferik Rr."Adem Jashari".
  - Sistemi i kanalizimit për disa pjesë të qytetit,
  - Shtrimi me kupëza betoni për disa rrugica-trotuareve të qytetit,
  - Izolimi i Kulmit dhe dyshemesë së shkollës fillore "Ilaz Thaçi"
  - Ngrohja Qendrore për shkollën fillore "Kështjella e Diturisë" (aplikacion projekt)
  - Fasadimi i objektit Komunal,
  - Sistemi i një pjese të ujësjellësit të Glloboçicë në Lagjen e Re, etj.
- Mbikëqyrjes së punimeve në teren dhe ndihma punëkryesit në realizimin e projekteve,
- Përgatitjes së raporteve për përfundim të punimeve për projektet kapitale të realizuara, të cilat janë gjithsej 1 raport,

Më poshtë po japim listën e projekteve investive kapitale si dhe statusin e tyre momental:

### III Kërkesat e qytetarëve– Personave fizik dhe juridik

Në fillim të gjashtë mujorit të vitit 2011 kemi shqyrtuar 8 kërkesa të mbetura nga viti 2010.

Gjatë këtij gjashtë mujori të vitit 2011 Drejtorisë – Sektorit të Urbanizmit, i janë bërë 30 kërkesa të cilat kryesisht kanë të bëjnë me kërkesa për Leje Ndërtimi, Pëlqime, ndërrim të destinacionit, shfrytëzim të pasurisë komunale etj.

Nga numëri i lartpërmendur i kërkesave:

- 11 kërkesa janë miratuar
- 8 janë refuzuar si të pabaza
- 3 kërkesa janë dhënë informacione shtesë
- 8 kërkesa janë në shqyrtim e sipër

Gjatë kësaj periudhe kemi lëshuar:

- 2 Leje Ndërtimi
- 1 Leje Ndërtimi e trashëguar nga viti 2010
- 1 Aktvendim – (Leje Pune)
- 5 Pëlqime,
- 1 Vërtetim.

### IV Të Hyrat për vitin 2011 në sektorin e Urbanizmit

Në gjatëmujorin e parë të vitit 2011 Sektori i Urbanizmit ka realizuar të hyra në shumë prej: 3,293.32 €.

#	Të Hyrat totale për gjashtëmujorin e par të vitit 2011 nga Urbanizmi	
1	Nga taksat për leje ndërtimi.	2,163.32 €
2	Nga Panot reklamuese.	1,080.00 €
3	Nga dhënia e pëlqimeve të ndryshme.	50.00 €
~	<b>Gjithsej:</b>	<b>3,293.32 €.</b>

### V INSPEKTORI I NDËRTIMTARISË

Gjatë kësaj periode gjashtëmujore si inspektor i ndërtimit përveç punëve dhe detyrave tjera ka bërë edhe:

6 Procesverbale

4 **Urdhëresa** të ndryshme

45 **Urdhëresa** për subjektet afariste mos pirjes së duhanit i miratuar vitin 2010  
urdhëresat janë shpërndarë në bashkëpunime me inspektoren sanitare.

75 **Urdhëresa** për mbeturina në bashkëpunim me inspektoren sanitare.

Po ashtu kemi larguar nga shitja artikuj të dyshimtë për përdorim siç është rasti me JAFa KEKS-at dhe artikuj të tjerë me afat të skaduar.

-Në lëmin e ambientit janë bërë inspektime të rregullta për hedhje të mbeturinave, kyçje në kanalizim, keqpërdorim të ujit janë shqiptuar gjoba mandatore për hedhje të mbeturinave në vende publike.

Kemi mbikëqyr edhe fabrikën e çimentos “**Sharr Beteiligungs**” ku pas çdo ndotje që kemi vërejtur nga kjo kompani kemi reaguar me vërejtje me shkrim dhe kemi paraqitur pakënaqësitë që na i sjell kjo kompani neve si qytetar dhe zyrtar në komunën e Hanit të Elezit dhe pas çdo ndotje janë njoftuar inspektorati mjedisor pran MMPH si dhe është bërë inspektimi i kësaj kompanie në bashkëpunim me inspektorët mjedisor të MMPH ku kemi dhënë vërejtjet tona për ndotje të mjedisit dhe nga kjo kompani gjegjësisht nga zyrtari për mjedis i kësaj kompanie është përpiluar një raport teknik për të na njoftuar lidhur me investimet që do ti bëjnë gjatë periudhës dhjetor 2011-shkurt-2012 .

Kemi pasur edhe **Ditën Ndërkombëtare të Tokës(22 prill)** ku është punuar në pastrimin e qytetit ku ky aksion ishte i koordinuar me shkollat, kompaninë “Higjiena” fabrikën “Sharr-cem e institucione të ndryshme të cilat veprojnë në këtë Komunë si OSBE, KFOR-i e qytetar të tjerë. Po ashtu në muajin Prill në organizim të Intercooperation kemi qenë në udhëtim zyrtar në Slloveni lidhur me menaxhimin e mbeturinave .

Kemi pasur seminare dhe takime të ndryshme lidhur me mjedisin,inspektimin sanitar si dhe çështjet gjinore.

Në bashkëpunim me inspektorët e Ministrisë së Mjedisit është bërë inspektimi i objekteve rreth magjistrales.

Kemi pasur një bashkëpunim edhe me Policinë e Kosovës për çdo rast që ata kanë hasur në teren me kohë na kanë njoftuar për marrjen e rasteve për procedurë të mëtutjeshme. Janë kryer punë dhe detyra tjera të dhëna nga drejtorët.

Punët e kryera i kemi paraqitur në formë tabelare:

Pranime sanitare –teknike mbi plotësimin e kushteve higjieno-sanitare	38	Subjekte afariste
Komisioni për ndërrim destinimi të tokës	6	
Inspektimi i ujërave të pijshëm DSHPA	6	
Inspektimi i ujërave të zeza	13	
Mostra e ushqimit të dërguara për analizë	-	
Procesverbale të lëshuara gjatë inspektimit	78	
Aktvendime për ndalim pirjes së duhanit	Në të gjitha subjektet	

## **ELEMINIMI I DEFEKTEVE NË UJESJELLES**

Ne si Drejtori kemi rregulluar apo eliminuar defektet që kanë ndodhur në ujësjellësin e Komunës tone. Defekteve të eliminuara në ujësjellësin e Hanit të Elezit na kanë percjellur edhe këtë vite.

Nga pëlqitjet e shpeshta te gypit te ujësjellësit te shkolla fillore “Ilaz Thaqi”, ne si drejtori kemi marre iniciativë për ndërrimin gypit ne gjatësi prej 48m (metrave).

Po ashtu kemi bërë pastrimin e kanalizimit atmosferik dhe atij fekal.

Drejtoria jonë ka paraqitur kërkesë KFOR-it për të na ndihmuar me sektorin zjarrfikësve (autocistern, trajnime, konsulta).

### **TE HYRAT E SHERBIMEVE PUBLIKE NGA UJESJELLSI**

Të hyrat nga ujësjellësi në Drejtorinë Shërbimeve Publike janë bërë që të gjitha duke paguar shumën e caktuar prej 50 eurove për kyçje në sistemin ujësjellësit të Dimces dhe atë të Glloboqices.

Të hyrat në drejtori janë : 700 € të gjitha këto nga kyçjet në ujësjellës.

### **TE HYRAT E SHERBIMET PUBLIKE NGA PANOT REKLAMUESE**

Te hyrat nga panot reklamuese apo billboard-at për gjashtë mujorin vitit 2011 ne drejtorinë shërbimeve publike janë ne vlerën prej: 2520 €

### **SHËRBIMI I ZJARRFIKËSVE –SHZSH-**

Gjate këtij gjashtëmujorit të vitit 2011 kemi intervenuar 11 herë , nga këto intervenime janë intervenime fushore, malore. Po ashtu kemi pasur edhe disa ushtrime në teren, prej të cilave janë ushtrimet në teren në fshatin Seçishtë në një pjesë malore, ushtrime në pjesën e fshatit Gorance dhe ushtrime në shatin Puset e Nikes.

Vlen të theksohet edhe ndihma e ofruar qytetarëve në Han të Elezit në tri raste për hapjen e kanalizimeve dhe një herë në hapjen e një gypi në qytet. Furnizimi me ujë për qytetaret katër herë (4 here).

Reshjet e breshërit që kanë rënë me datën 08.06.2011 kanë bërë dëme në kulturat bujqësore në dy fshatra në fsh.Laç dhe Seçishtë ku komisioni ka vlerësuar dëmin në fsh.Laç 13 509.28€ ndërsa në fsh.Seçishtë 2 541.30€, totali në vlerë 16 050.58 €

### **Sektori i Pylltarisë:**

#### **Raporti gjashtëmujor për vitin 2011**

Në sektorin e pylltarisë janë të ndarë në katër sektor:

1. Sektori i mbrojtjes
2. Pyjet private
3. Konfiskimi i drunjëve
4. Zjarret pyjore.

#### **1. Sektori i mbrojtjes**

Për gjashtëmujorin e parë të këtij viti kemi ngritur 82 fletëparaqitje me një sasi prej 164.42m<sup>3</sup> ose në të holla 17226.42 € ku prej tyre në Gjykatën Komunale për Kallëzim Penal në Ferizaj, janë 13 fletëparaqitje me një sasi prej 81.57m<sup>3</sup> me vlerë prej 9146.54 € dhe 69 fletëparaqitje për në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje në Kaçanik me një sasi prej 82.85m<sup>3</sup> me vlerë prej 8079.88€. Vlen të ceket se të gjitha fletëparaqitjet janë nga terreni i Llokmes ku prerësit ilegal më së shumti vijnë nga fshatrat Gjurgjedellë, Paldenicë, Dermjak dhe Neçavcë. Prej të gjitha këtyre fletëparaqitjeve nga gjykata është vendosur vetëm një lëndë në procedur të shkrutër ku është dënuar me vlerë prej 300€ në transport ilegal për kundërvajtje.

#### **2. Pyjet private:**

Janë pranuar, shqiptuar dhe janë dorëzuar në Drejtorinë e APK-së në Ferizaj 40 kërkesa për prerje në pyje private ku prej tyre janë shqipëtuat 21 lëndë dhe vulosur në cungë në një sasi prej 652.38m<sup>3</sup>, ndërsa janë vulosur dhe përcjellur 277.90m<sup>3</sup> ku janë paguar 648.20 € në emër të taksës për pyje private.

#### **3. Konfiskimi i drunjëve**

Janë konfiskuar 10.50m<sup>3</sup> dru zjarri ku prej këtyre 2.80m<sup>3</sup> i'u është dhënë SH.F."Veli Ballazhi" në fshatin Gorancë ndërsa sasia prej 7.70m<sup>3</sup> është në depon e komunës tonë.

#### **4. Zjarret pyjore**

Kemi patur të shfaqura zjarre në muajin Prill në teritorin e fshatit Gorancë në një sipërfaqe prej 5 ha dhe atë në sektorin privat 2 ha ndërsa në atë public 3 ha. Vlenë të

të komuniteteve. Vlenë të përmendet gjithashtu IOM si implementues i programit të EU-së Kosova e Bukur ku aplikacionet do të dorëzojmë me 15.07.2011.

Në rrjedhën e këtyre angazhimeve Drejtorët komunal për ekonomi dhe zhvillim me organizimin e Asociacionit të Komunave të Kosovës jemi takuar më 12/05/2011 në takim pune ku është diskutuar për themelimin e 'one-stop shopeve (qendrave për regjistrimin e bizneseve) dhe bartjes së kompetencave në të gjitha komunat me qka kishte me u bërë më e lehtë regjistrimi i bizneseve në komunat përkatëse.

Me anë të një vendimi nga kryetari i komunës unë si drejtor i zhvillimit ekonomik, jamë caktuar në grupin punues në planin për menagjimin e mbeturinave, ku në bashkëpunim me Logos-in, jemi duke bërë draftimin e planit për menagjimin e mbeturinave. Këtij plani i kanë parapri disa takime pune me Logos-in, nga të cilët kemi marrë ndihmë profesionale se si ta punojmë këtë draft plan, duke përfshirë pikat kryesore të gjendjes së tanishme, planifikimit dhe menagjimit, gjithashtu kamë marrë pjesë në prezantimin e planit investiv në infrastrukturën e ujësjellësit dhe kanalizimit të organizuar nga Shukos-i e që janë financuar nga USAID-i.

Pjesë e punës së kësaj drejtorie ka qenë edhe bashkëpunimi me drejtorin e buxhetit dhe financave në hartimin e qarkores buxhetore 2012-2014, si dhe planifikimit për investime kapitale dhe njëherit kemi filluar edhe me planifikimin rrethë rishikimit të buxhetit.